



**Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/Opstina Drgas**



KRYETARI I KOMUNËS

02.Nr.004-136/12

13.06.2012.

D r a g a s h

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Nr. 03/L-040, i publikuar në ("Gazetën zyrtare të Republikës të Kosovës " Nr. 28/2008) , nenit 57. Të Statutit të komunës të Dragashit, Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008 dhe nenit 6. Të Rregullores për menaxhimin e programit, organet kompetente, procedurat dhe kriteret e përfitimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar,nr. 10/2012 e miratuar nga Qeveria e Kosovës, Kryetari i komunës të Dragashit, merr:

**V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR RIINTEGRIM**

I.

THEMELOHET Komisioni komunal për riintegrimin e personave të riatdhesuar për komunën e Dragashit.

II.

Komisioni komunal i cekur në pikën e I. Të këtij Vendimi do të jetë në këtë përbërje:

- | | | |
|-------------|------------|--|
| 1. Rami | Mejzini | - përfaqësues për arsim, |
| 2. Sadik | Zejnullahu | - përfaqësues për shëndetësi , |
| 3. Ibrahim | Gashi | - përfaqësues për mirëqenie sociale , |
| 4. Fitim | Kurteshi | - përfaqësues për punë dhe punësim , |
| 5. Rexhep | Ibrahimi | - përfaqësues për shërbime publike , |
| 6. Xhylbear | Taipi | - përfaqësues për planifikim dhe urbanizëm |
| 7. Hamdi | Sheapi | - përfaqësues për gjeodezi dhe kadastër, |
| 8. Hilmi | Dauti | - zyrtar për integrime evropiane dhe |
| 9. Vezaip | Kajkush | - zyrtar për riintegrim |

III.

Komisioni komunal për riintegrim ka për detyrë që të shqyrtoj dhe të nxjerr vendime për kërkesat e personave të riatdhesuar si që janë:

1. Furnizimi me artikuj ushqimor dhe higjenik,
2. Strehim/banim ,

3. Ofrimin e ndihmës shëndetësore,
4. Asistencën shtesë (ad hoc) sipas nevojës,
5. Pakon e asistencës materiale,
6. Pakon e asistencës për orendi dhe
7. Pakon e asistencës për dimër (dru djegëse)

IV.

KKR është përgjegjës edhe për identifikimin e nevojave të të riatdhesuarve lidhur me:

1. Organizimin e kurseve shtesë të gjuhës,
2. Lehtësimin e qasjes në arsim,
3. Identifikimin e mundësive për ofrimin e trajnimeve profesionale dhe
4. Qasje në tregun e punës

V.

Anëtarët e komisionit komunal për riintegrim , për punën e bërë do ti raportojnë Kryetarit të komunës .

VI.

Ky vendim hynë në fuqi një ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i komunës.

Vendimi ju dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit ,
- Zyrës komunale për komunitete dhe kthim dhe
- Arkivit.



KRYETARI I KOMUNËS


Salim Jenuzi